



Pranuar / Dorëzuar Puniljena / Prodato Received / Delivery		17-12-2021		viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	6222/2021		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.960/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1424/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.169/2020 të datës 22.06.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Luan Haradinaj”, Ndërtesa e re e Policisë së Kosovës, kundër Vendimit me Nr.03/02-133/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.12.2021 mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.169/2020 e datës 22.06.2020 e parashtruar nga ankuesi.**
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.03/02-133/20 i datës 06.04.2020 i Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës.**

A r s y e t i m

Ankuesi e punësuar në bazë të Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 10.08.2009 në pozitën “Përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas” në Policinë e Kosovës, më datë 23.12.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës për kompensim të diferencës së koeficientit për tri vite në mënyrë retroaktive. Komisioni për Ankesa të Policisë së Kosovës, më datë 22.01.2020 ka nxjerr Vendim me numër:419-KA-2019 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Drejtorinë e Personelit. Pas veprimeve të ndërmarra më datë 21.02.2020 nëpërmjet e-mailit është njoftuar ankuesja se meqenëse aprovimi i koeficienteve të pozitive të shërbyesve civil është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike nuk mund të vendosim pa marr përgjigje nga ministria.

Ankuesja kundër njoftimit të datës 21.02.2020 të Drejtorisë së Personelit, më datë 06.03.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës lidhur me mos rregullimin e koeficientit. Komisioni për Ankesa të Policisë së Kosovës më datë 06.04.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. Nr.03/02-133/20 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.03/02-133/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, më datë 22.06.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1207/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.06.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës më datë 15/07/2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimit A.nr.1424/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 19.11.2021; Njoftimin e datës 30.07.2021; Ankesën me numër protokoll 1207/2020 të datës 22.06.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimin e Policisë së Kosovës për sistemim për kohë të pacaktuar i datës 03.12.2019; Vendimin e Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës i datës 22.01.2020; E-mailin e datës 21.02.2021 dërguar nga Menaxherja e Personelit të Policisë së Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 23.12.2019; Kopjen e Konkursit në Policinë së Kosovës me referencë:07/1-01R/06/19; Kopjen e Konkursit në Policinë së Kosovës me referencë:07/1-01R/04/17; Kopjen e Konkursit në Policinë së Kosovës me referencë:07/1-01R/02/18; Ankesën e ankuesit të datës 06.03.2020 kundër përgjigjes së Drejtorisë së personelit; Vendimin me Nr.03/02-133/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.06.2021; Përgjigje në ankesë e datës 15.07.2020; Kontratën e punës së ankuesit të datës 10.08.2009; E-mailin e datës 05.12.2018 dërguar nga _____ për _____ Kartela e nëpunësit të datës 06.07.2020; Shkresën e quajtur përgjigje në ankesë e bashkangjitur në e-mail.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon për harmonizim të koeficientit si të nëpunësve të nivelit qendror dhe kompensim retroaktiv të koeficientit për tri vite, ka konstatuar që Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës ka bërë përpjekje të nevojshëm për harmonizim të koeficienteve ku më datë 05.12.2018 kanë kërkuar nga Ministria e Administratës Publike që të bëhet klasifikimi i vendeve të punës për stafin civil në Policinë e Kosovës, ndërsa pas Vendimit me Nr.03/02-33 të datës 28/01/2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës më të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e ankuesit dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Drejtoria e Personelit, Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës më datë 13.02.2020 ka dërguar kërkesë për harmonizim të koeficienteve për pozitat e shërbyesve civil në Policinë e Kosovës tek Ministria e Administratës Publike por nuk ka marr përgjigje lidhur me këtë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Policia e Kosovës ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për harmonizim të koeficienteve siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr. 33/20120 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, pasi që në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe kësaj rregulloreje, përcaktohet që *“grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa”* nëni 1 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si rrjedhojë harmonizimi i koeficienteve bëhet nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për



administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, në këtë kuptim Policia e Kosovës duhet të bëjë vetëm planifikimin për harmonizim të koeficienteve veprim të cilin e ka ndërmarrë me rastin e kërkesës së datës 05.12.018 të cilët kanë kërkuar nga Ministria e Administratës Publike, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar, ngase ngritja e koeficientit nuk është në kompetencë të Policisë së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.03/02-133/20 i datës 06.04.2020, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.960/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

